



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:228868

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05402832

C.nr.345/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K..., Dega në Mitrovicë, Bulevardi ..., kundër të paditurve S.M dhe F.M, të dy nga Vushtrria rruga ..., me objekt kontesti Pagesë e borgjit, vlera e kontestit 4,981.02 euro, jashtë seance më datë 01.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me numër C. nr. 345/18 e datës 02.08.2018, për pagesën e borgjit, e paditësit K..., Dega në Mitrovicë, Bulevardi ... kundër të paditurve S.M dhe F.M, të dy nga Vushtrria rruga ... për shkak të mosdorëzimit të provave në ekzemplar të mjaftueshëm për palët e paditura.

A r s y e t i m

Paditësi K..., Dega në Mitrovicë, Bulevardi ... me datë 02.08.2018, ka paraqitur padi për pagimin e borgjit në shumën prej 4,981.02 euro, kundër të paditurve S.M dhe F.M, të dy nga Vushtrria rruga ...

Gjykata me aktvendimin e datës 26.02.2024, ka ftuar paditësin që në afat prej 3 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi, gjykatës t'ia dorëzojë në ekzemplar të mjaftueshëm provat për palët e paditura, me paralajmërimin se gjykata do të merr aktvendim me të cilin do ta hedh poshtë padinë, në kuptim të dispozitës së nenit 102.3 dhe 102.4 të LPK-së.

Paditësi me datë 01.03.2024, gjykatës ia ka dorëzuar vetëm një ekzemplar të provave, edhe pse në padi janë të përcaktuar dy të paditur.

Marr parasysh faktin se paditësi nuk ka vepruar sipas thirrjes së gjykatës për dorëzimin e provave, gjykata bazuar në të lartcekurat dhe konform nenit 102 par.3 dhe 102 par.4, lidhur me nenin 391 pika (g) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C. nr. 345/18, me datë 01.03.2024

Gjyqtari

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.